



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE JURIDIKE
SEKTORI I SEKRETARI-ARKIVIT

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Profekti

Nr. Prot. 8374, Data 13.08.2024

Shkurtimi i lëndës _____

Për trajtim nga:	<u>-> znj. Arlinda Hajdini</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	<u>-> znj. Delina Hoti</u>
Me porosi:	<u>-> z. Selman Çepele</u>

Afati: normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (Brenda ditës) Pa afat/ për dajeni Tjetër _____ ditë

Data 14.08.24 Nr. Prot. 6431

Nënshkrimi: (TITULLARI) _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim specialisti: _____


Me porosinë: _____

rajtim i materialit përfunduar më: _____, Specialisti

rajtim i materialit pranuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike

rajtim i materialit miratuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike

rajtim i materialit miratuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 837/11 Prot.

Fier, më 13.08.2024

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 45, Nr. 46, dhe Nr. 48, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 31.07.2024.

BASHKISË ROSKOVEC
KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC

Roskovec

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 5490/2 prot. datë 02.08.2024, protokolluar pranë Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 837 prot. datë 08.08.2024, bazuar në ligjin Nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut” (i ndryshuar) neni 4, pika 1, neni 8, shkronja “a”, “j” neni 16, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3, pika 2, shqyrtuam ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 31.07.2024, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 8, datë 31.07.2024, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 69, prot. datë 05.01.2024, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimeve, shprehemi si më poshtë:

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 45, datë 31.07.2024, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të PBA 2025-2027” shoqëruar nga projektvendimi Nr. 45, datë 26.07.2024, protokolluar me Nr. 5765 prot. datë 26.07.2024, dhe relacioni shpjegues Nr. 5765/1 prot. datë 26.07.2024, është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, neni 41, pika 1; Ligjin Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar), neni 37; Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” (i ndryshuar) neni 4, neni 32; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr. 3, datë 28.02.2024, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”.

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 46, datë 31.07.2024, “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024” shoqëruar nga projektvendimi Nr. 46, datë 26.07.2024, protokolluar me Nr. 5766 prot. datë 26.07.2024, dhe relacioni shpjegues Nr. 5766/1 prot. datë 26.07.2024, është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1/b, dhe 1.3/c, neni 54, shkronja “dh”; Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 6, neni 15,

neni 44; Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar) neni 6, shkronja “d”, neni 10, neni 45; si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 48, datë 31.07.2024, “Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2024” i shoqëruar nga projektvendimi Nr. 48, datë 31.07.2024, protokolluar me Nr. 6047 prot. datë 31.07.2024, dhe relacioni shpjegues Nr. 185 prot. datë 23.07.2024, Ju kthehet për arsyet e mëposhtme:

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 414, datë 8.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” është i vetmi akt juridik që rregullon posaçërisht mënyrën dhe kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile. Në pikën 2 të saj, kjo VKM përcakton kriteret e përgjithshme se si duhet të përdoret fondi i kushtëzuar.

Në rastin konkret, për miratimin e vendimit jeni bazuar në pikën 3, nënpika 3.1/e, të VKM-së Nr. 414, datë 8.07.2021. Kjo pikë lejon përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit *për mbajtjen në gatishmëri të infrastrukturës së ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre*. Ky vendim ka për objekt përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për të rikonstruktuar murin e varrezave të qytetit, i cili sipas relacionit bashkëlidhur vendimit ka pësuar rrëshkitje dhe është dëmtuar në një pjesë të tij. Nga ndërhyrja që kërkoni të kryeni, bëhet fjalë për një rikonstruksion të një muri rrethues të një prone publike dhe jo për mbajtjen në gatishmëri të infrastrukturës së ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmytja dhe digat e rezervuarëve siç kërkon pika 3, nënpika 3.1/e, e VKM-së.

Për sa më sipër, vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 48, datë 31.07.2024, “Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2024” Ju kthehet si vendim në kundërshtim me VKM-në Nr. 414, datë 8.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3, nënpika 3.1/e.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËNPREFEKTI**

Mbarime Isufaj

